



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM

Nr. 279, datë 01.07.2021

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË DURRËS

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Erarbër Madhi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Shfuqizimin e aktit administrativ, vendim nr.3942/1, datë 17.07.2018, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, etj.”

GJYKATA E POSACME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gerd Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: “Nenet 283/a/2, 333/a/1, 334 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 283/1 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 130/a/4 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali dhe Skënder Damini, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkatërrim i pronës me zjarr etj.”

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Nazmi Troka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...} {...}, etj.; Objekti: “Dërgim në gjyq”.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Toro, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen gjyqësore me Kërkues: Shoqëria {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtimin e gjyqtares {...}nga gjykimi i çështjes administrative nr. {...} regjistri, datë regjistrimi 13.06.2019 dhe çështjes administrative nr. {...} regjistrimi, datë 30.09.2019 të bashkuara në një çështje të vetme me vendimin nr. {...}regj.themeltar datë 12.12.2019”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR